

## CURRENT TEACHING STRATEGIES IN LOWER SECONDARY EDUCATION

**Edita Haxhijaha**

University "Fehmi Agani", Gjakovo, Kosovo, edita.haxhijaha@uni-gjk.org

**Abstract:** Strategy is the ability to lead or manage the teaching work in order to successfully achieve the objectives set for the lesson.

Knowledge of contemporary teaching strategies is a very important part of the education package, which aims to create well-informed students, responsible and active teachers who will be willing to take initiative for the benefit of society.

The key object of this research is the identification of current teaching strategies and the research of the impact of the professional responsibility of the teachers on the tasks, implementation of the curriculum, understanding of the changes in education, obligations towards society, students and parents.

The purpose of the research is to identify and accurately implement the current teaching strategies in the schools of the Municipality of Prizren. The main aim is not only description of the contemporary strategies for teaching but also analyzing, clarification of notions as the result of changes in education.

The research was conducted in Prizren (a city in the Republic of Kosovo), with lower secondary school teachers from sixth grade (VI) to ninth grade (IX), in 10 schools in the Municipality of Prizren, of which 6 urban schools and 4 rural schools.

The sample consists of 183 subjects, 112 males and 71 females. Teachers' statements were anonymous.

Special attention has been paid to the attitudes of teachers towards the reform and changes in education, with special emphasis on teaching, especially in the moments of introduction of contemporary strategies in teaching, and their reflection in the relations of teachers with colleagues, students, parents, but also of students with teachers, student-student relations, etc., on one hand and on the other hand the attitude towards curricula and teaching contents, classroom management, teaching methods, student motivation, ways of presenting the lesson and even the evaluation of knowledge.

Results of this research will contribute to improving the quality of teaching and learning and will influence learning to be more efficient and teaching to focus on learning and the use of strategies that will promote active student participation.

**Keywords:** contemporary strategies, school institutions, education techniques, teachers, students.

## STRATEGJITË AKTUALE TË MËSIMDHËNIES TË ARSIMIT TË MESËM TË ULËT

**Edita Haxhijaha**

Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani", Gjakovë, Kosovë, edita.haxhijaha@uni-gjk.org

**Abstrakt:** Strategjia është shkathtësia e udhëheqjes ose menaxhimit të punës mësimore me qëllim të realizimit të suksesshëm të objektivave të parashtruara të mësimi. Njohja e strategjive bashkëkohore të mësimdhënies është pjesë shumë e rëndësishme e pakos së edukimit, që synon krijimin e nxënësit të informuar mirë, mësimdhënësin e përgjegjshëm dhe aktiv të cilët do të jenë të gatshëm të marrin iniciativa në dobi të shoqërisë. Objekt themelor i këtij hulumtimi është evidentimi i strategjive aktuale të mësimdhënies dhe hulumtimi i ndikimit të përgjegjësisë profesionale të mësimdhënësit ndaj detyrave, realizimit të planprogramit, të kuptuarit të ndryshimeve në arsim, obligimeve ndaj shoqërisë, nxënësve dhe prindërve. Qëllimi i hulumtimit është identifikimi sa më i saktë i zbatimit të strategjive aktuale të mësimdhënies në shkollat e Komunës së Prizrenit. Synimi themelor është jo vetëm përshkrimi i strategjive bashkëkohore të mësimdhënies por edhe analiza, sqarimi i nocioneve si rezultat i ndryshimeve në arsim.

Hulumtimi është realizuar në Prizren (qytet në Republikën e Kosovës), me mësimdhënësit të shkollave të mesme të ulëta nga klasa e gjashtë (VI) deri në klasën e nëntë (IX), në 10 shkolla të Komunës së Prizrenit, prej tyre 6 shkolla urbane dhe 4 shkolla rurale. Mostra përbëhet nga 183 subjekte, 112 meshkuj dhe 71 femra. Deklarimet e mësimdhënësve kanë qenë anonime. Vëmendje e posaçme i është kushtuar qëndrimeve të mësimdhënësve ndaj reformës dhe ndryshimeve në arsim, me theks të posaçëm mësimdhënies, sidomos në momentet e futjes së strategjive bashkëkohore në mësim, dhe reflektimit të tyre në raportet e mësimdhënësve me kolegë, me nxënës, prindër, por edhe të nxënësve me mësimdhënësit, raportet nxënës – nxënës, etj, në një anë dhe në anën tjetër qëndrimi ndaj planprogrameve e përmbajtjeve mësimore, ndaj menaxhimit të klasës, metodave të mësimdhënies, motivimit të nxënësve, mënyrave të prezantimit të mësimi e deri te vlerësimi i diturive. Rezultatet e këtij hulumtimi do të

kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe do të ndikojë që të nxënit të jetë më efikas dhe mësimdhënia të përqëndrohet në të nxënit dhe përdorimin e strategjive që do të nxisë pjesëmarrjen aktive të nxënësve.

**Fjalët kyçe:** strategjitë bashkëkohore, institucionet shkollore, teknikat arsimore, mësimdhënësit, nxënësit.

## 1. HYRJE

Shkolla sot është një institucion ku nuk kërkohet më riprodhim apo zotërim të informacionit, por ajo sot ka një mision të ri që të përgatitë gjeneratat e reja që të jenë në gjendje për të kërkuar informacion, operuar dhe analizuar në mënyrë kritike dhe për të aftësuar nxënësit që të jenë në gjendje të zgjidhin probleme mjaftë të vështira dhe t'i shqyrtojnë rrethanat në mënyrë kritike, të ngrenë opinione të ndryshme dhe të marrin vendime të matura.

Arsimi dhe zhvillimi profesional i mësimdhënësve duhet të shihet si një detyrë e përrjetshme, dhe duhet të jetë e strukturuar në përputhje me rrethanat (Këndusi, 2018:5).


*Ndryshimet në arsim*

“Dikush thotë që shkollat po bombardohen nga ndryshimet; një tjetër vë në dukje se nuk po bëhet asgjë e re. Një hartues politikash akuzon se mësuesit i bëjnë qëndresë ndryshimit...” (Fullan, 2001:15). Ajo që duhet të besohet se pa reformë në arsim nuk mund të kemi të ardhme përparimtare dhe duhet të bindemi se ndryshimet në arsim janë të vazhdueshme, në mënyrë që arsimi t'i jepet një rol kryesor në zhvillimin e shoqërisë sonë.

*Strategjitë aktuale të mësimdhënies*

*Mësimi i individualizuar* nuk do të thotë në mënyrë të nevojshme punë e pavarur. Ai përfshinë punën e çdo nxënësi me detyrat mësimore të përcaktuara nga mësuesi, sipas nevojave të tij apo të saj, interesat dhe aftësitë, pra është mënyrë e ndërtimit të mësimi për të përshtatur nevojat individuale të nxënësve, interesat, aftësitë dhe ritmit në punë (Musai, 1999:268). *Mësimi problemor* - Është kërkesë e shkollës së re, në mënyrë të veçantë e shkollës dhe mësimi bashkëkohor. Nxënësit nxiten ta vërejnë dhe identifikojnë problemin, të gjejnë burimet dhe të vjelin të dhënat, t'i përpunojnë, analizojnë, sistemojnë, të nxjerrin dhe vërtetojnë konkluzionet në mënyrë individuale, në çifte ose në grup. Ai krijon dinamikën emocionale dhe intelektuale në mësim, motivon nxënësit për punë krijuese (Musai, 1999:178). *Mësimdhënia ndërvepruese* krahasuar me mësimdhënien tradicionale ka ndryshuar me ndryshimin e raporteve sociale dhe demokratizimin e jetës brenda shkollës, kjo ka bërë që edhe pozita e mësimdhënësit dhe e nxënësit në shkollë tashmë është më atraktive pasi që sot mësimdhënësi është një udhëheqës dhe organizues i mësimi, që udhëheq nxënësit për të qenë në gjendje që të jenë kërkues të informacionit në mënyrë të pavarur, që t'i zgjidhë problemet sado të ndërlikuara të jenë ato. “Sot, në qendër të mësimi është nxënësi. Mësuesi rregullon, përshtat interesat dhe nevojat e tij, në përputhje me synimet e mësimdhënies” (Musai, 2003:12). *Mendimi kritik gjatë leximit dhe shkrimit* - Për të shpjeguar etimologjinë e nocionit “të menduarit kritik” fillimisht nisemi nga konstatimi se fjala “kritik” ka disa kuptime si “kritikues”, “ngacmues”, “shpifës” etj. Mirëpo, kur fjala “kritik” është afër me fjalën “të menduarit”, atëherë merr një kuptim krejtësisht tjetër. “Njeriu që mendon në mënyrë kritike shquhet për “kritikën” në kuptimin grek dhe latin të fjalës, pra dikush që është i aftë të dallojë, të analizojë, të argumentojë dhe të gjykojë (Ismajli, 2012:37).

### *Strategjitë e mësimdhënies dhe të të nxënit*



Parashikimi



Ndërtimi i njohurive



Përforcimi

Në fazën e parashikimit mbillet një farë, në një truall pjellor. Por sukcesi i mësimi nuk varet vetëm nga kjo “farë”, ai duhet të mbështetet edhe në njohuritë ekzistuese të nxënësve, ashtu si fara merr ushqim nga trualli ku është mbjellë. Pasi është bërë puna themelore e fillimit, mësimdhënësi vazhdon me fazën e ndërtimit të njohurive; faza e grurit lëshon rrënjë dhe bima rritet. Mësimi përfundon me fazën e përforcimit. Kalliri i grurit është pjekur dhe përmban fara për shumë bimë të tjera; po kështu, edhe mësimi mund të çojë në shumë veprimtari të tjera (Temple & Crawford & Saul & Mathews & Makinster, 2006:3). Strategjitë për mësimdhënien dhe të nxënit siguron një mekanizëm për organizimin e mësimi. Ai jep një rrugë të të menduarit për mësimin. Kjo e aftëson mësimdhënësin, në mënyrë sistematike të: organizojë mësimin, nxjerrë qëllimet dhe objektivat e mësimi, planifikojë mbështetjen e veprimtarive, përfshijë nxënësit në procesin e të nxënit në mënyrë të qëllimshme, ndërtojë lidhje në përmbajtjen kurrikulare, përfshijë nxënësit në një bashkëbisedim të vazhdueshëm, çka e aftëson mësimdhënësin që, në mënyrë të qëndrueshme, të kontrollojë shkallën e të kuptuarit të nxënësve.

Të lexosh do të thotë të fillosh procedurën e të menduarit aktiv, një proces i cili merr udhë në sajë të hulumtimit në botën e dijes dhe të informacionit. Gjatë leximit njeriu hap diapazonin e tij mbi vende, kultura, popuj, ngjarje dhe të

dhëna e të gjitha fushave (Haxhijaha, 2015:2). Leximi i vëmendshëm është më shumë se të zhvilluarit e avancuar të leximit; ai është një mekanizëm për të mësuar nxënësit me argumente logjike, duke kritikuar arsyetimin e të tjerëve, për të mbledhur dëshmi nga teksti (Rruka, 2016:14). Kur struktura bëhet një proces i njohur, është e mundur të zbatohen disa teknika të mësimdhënies në nivele të ndryshme, duke ndërthurur mësimin me plotësimin e nevojave të veçanta të përmbajtjes apo të përmbushë qëllime të veçanta. Këtu do të përshkruaj disa strategji, të cilat mund të zbatohen brenda kontekstit të strukturës. Strategjitë janë përshkruar në hollësi, me udhëzime për zbatimin dhe gjetjen e strukturës së përshtatshme për zbatim. *Kllasteri ose grumbullimi i mendimeve*, që ndonjëherë, në literaturë emërtohet “harta e mendimeve” ose edhe “pema e mendjes”, është një teknikë që nxit nxënësit të mendojnë lirshëm dhe hapur rreth një çështjeje. Ai kërkon një strukturë të mjaftueshme për të nxitur të menduarit për lidhjet mes ideve (Musai & Ballhysa & Gjokutaj & Kërçiku & Zisi, 2004:81). *Pesëvargëshi* – poemë pesëvargëshe e parimuar që përdoret si mjet për të inkurajuar nxënësit të reflektojnë për një çështje. Vargjet kanë këtë përbërje: *Titulli* (zakonisht një emër), *përshkrimi* (përbëhet nga dy mbiemra), *veprimi* (përbëhet nga tri folje), *ndjenjë* (një fjali me katër fjalë) dhe *përcaktimi i thelbit* (një emër sinonim me atë të titullit) (Musai, 2005:275). *Mësimdhënia e ndërsjellë* - Dihet se rruga më e mirë për të mësuar është të mësosh duke dhënë mësim. Ndaj teknika që vijon është e tillë, se aftëson gjithë nxënësit të provojnë rolin e mësuesit në udhëheqjen e të tjerëve, përmes tekstit. Teknika përshtatet mirë, sidomos në tekste informative (Musai & Ballhysa & Gjokutaj & Kërçiku & Zisi, 2004:36). *Harta e tregimit* është një mënyrë e provuar dhe e vërtetë për të nxjerrë në pah elementët e rëndësishëm të një teksti tregimtar (Buehl, 2001; Jons dhe Berglund, 2001). Tabloja e hartës së tregimeve është një version lëvizor-dramatizues i këtij organizuesi grafik. Ajo mund të përdoret edhe me tekste nga historia, si përvijime të ngjarjeve të rëndësishme, me ngjarjet mbështetëse që tregohen aty dhe që çojnë deri në pikën kulmore (p.sh.: një luftë). Mësuesit e shkencës e kanë përdorur me sukses, madje edhe për procese si shpërthimet vullkanike dhe për diskutimin e zgjidhjeve për problemet mjedisore (Zwiers, 2005:78). Teknikat e të nxënësve ndërveprues inkurajojnë bashkëpunimin, por qëllimi përfundimtar është zhvillimi i mendimit të pavarur (Gashi-Shatri, 2015:56). Cilësia e mësimdhënësve ende mbetet sfidë krahas mos zbatimit të promovimit të bazuar në performancë dhe mungesës së një sistemi funksional për zhvillim gjatë shërbimit (MASHT, 2015:24).

## 2. METODOLOGJIA E KËRKIMIT

Mësimdhënia, si proces, gjithnjë në evoluim ka sjell dhe sjell vazhdimisht risi ndaj të cilëve mësimdhënësit duhet të jenë gjithmonë të përgatitur për t'i përballur me sukses dhe me sa më pak vështirësi. Mësimdhënësit duke u ballafaquar me ndryshimet e tilla, të ndodhura gjithnjë në proces zhvillimi siç është mësimdhënia, përjetojnë çaste herë të këndshme, herë të pakëndshme.

Objekt themelor i këtij hulumtimi është evidentimi i strategjive aktuale të mësimdhënies dhe hulumtimi i ndikimit të përgjegjësisë profesionale të mësimdhënësit ndaj detyrave, ndaj realizimit të planprogramit, ndaj të kuptuarit të ndryshimeve në arsim, obligimeve ndaj shoqërisë, nxënësve dhe prindërve. Qëllimi i hulumtimit është identifikimi sa më i saktë i zbatimit të strategjive aktuale të mësimdhënies në shkollat e Komunës së Prizrenit. Të gjitha konstatimet do të bazohen në deklaratimet e mësimdhënësve përmes pyetësorit me nivele të shprehura numerikisht.

### 2.1. Objektivat e hulumtimit

- T'u mundësohen mësimdhënësve strategji dhe teknika për ngritjen e cilësisë në mësim.
- Të përmirësohen praktikat mësimore.

### 2.2. Hipoteza e hulumtimit

**H.1.** Përdorimi i strategjive bashkëkohore të mësimdhënies nxit pjesëmarrjen aktive të nxënësve në mësim dhe krijimin e një klime relaksuese gjatë diskutimit në klasë.

### 2.3. Mostra

Hulumtimi është realizuar në Prizren (qytet në Republikën e Kosovës), me mësimdhënës të shkollave të mesme të ulëta nga klasa e gjashtë (VI) deri në klasën e nëntë (IX), në 10 shkolla të Komunës së Prizrenit, prej tyre 6 shkolla urbane dhe 4 shkolla rurale. Mostra përbëhet nga 183 subjekte, 112 meshkuj dhe 71 femra. Deklarimet e mësimdhënësve kanë qenë anonime. Nga viset urbane janë 157 subjekte, kurse nga viset rurale janë 26 subjekte. Ndarja sipas zonave urbane dhe rurale, do të shërbejnë si variabla që konsideroj ndikohen ndryshe sa i përket zbatimit të strategjive të mësimdhënies në shkollat e tyre.

### 2.4. Instrumentet e hulumtimit

Me qëllim që të mblidhi të dhëna mbi strategjitë aktuale të mësimdhënies, si instrumente për hulumtim kam përdorur anketën dhe intervistën. *Nga intervistat* - qëllimi i intervistave ishte të analizohen situatat në sistemin arsimor. Çështjet të cilat janë diskutuar janë procedurat e vendimmarrjes, zhvillimin e stafit, informimin e prindërve dhe involvimin e tyre në vendimmarrje në shkolla. *Nga anketat* - me anë të anketave janë siguruar të dhënat mbi metodologjinë, procesin mësimor, disponimin e literaturës përkatëse dhe pajisjeve kompjuterike, planprogramin, suksesin e nxënësve etj. Të dhënat e grumbulluara, përmes këtyre instrumenteve, ishin burimi më i nevojshëm për


dhënien e konstatimeve, krahasimeve, sugjerimeve dhe gjykimeve në këtë hulumtim. Metodën, teknikat dhe instrumentet që kam përdorur më ndihmuan në vërtetimin e hipotezës.

### 2.5. Metodën e hulumtimit shkencor

**Metoda:** *Shqyrtim literature* - ka të bëjë me njohjen e të arriturave më të reja mbi mësimdhënien dhe strategjitë aktuale të mësimdhënies, me analizën e disa veprave dhe punimeve nga autorë të ndryshëm në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaja, si ndihmë për mbledhjen e pastaj për veçimin e përmbajtjeve më relevante që u referohen strategjive aktuale të mësimdhënies në përgjithësi. *Metodat e përziera* - Janë kombinim i metodave sasiore dhe cilësore në mënyrën që i përshtatet më mirë studimit.


## 3. REZULTATET E HULUMTIMIT

Deklarimet e mësimdhënësve që punojnë në qytet dhe në fshat / *Histogrami 1.*



Sipas deklaramëve të 157 mësimdhënësve të shkollave urbane ose 85.79 %, për nivelin *punë e bërë me kënaqësi* janë deklaruar 123 mësimdhënës ose 78.34 %, për nivelin *punë e mundimshme* janë deklaruar 25 mësimdhënës ose 15.92% dhe për nivelin *obligim* janë deklaruar 9 mësimdhënës ose 5.73%. Mësimdhënësit e shkollave rurale nga 26 sa ishin gjithsej ose 14.20 %, në nivelin *punë e bërë me kënaqësi* janë deklaruar 18 mësimdhënës ose 69.23 %, në nivelin *punë e mundimshme* janë deklaruar 5 mësimdhënës ose 19.23% kurse për nivelin *obligim* janë deklaruar 3 mësimdhënës ose 11.53 %.

*Histogrami 2.*




Sipas deklaramëve të 157 mësimdhënësve të shkollave urbane, për nivelin *shumë mirë*, janë deklaruar 118 mësimdhënës ose 75.15 %, për nivelin *me shqetësim*, janë deklaruar 32 mësimdhënës ose 20.38 % dhe për nivelin *indiferent*, janë deklaruar 7 mësimdhënës ose 4.45 %. Mësimdhënësit e shkollave rurale nga 26 sa ishin gjithsej, në

nivelin *shumë mirë*, janë deklaruar 18 mësimdhënës ose 69.23 %, në nivelin *me shqetësim*, janë deklaruar 6 mësimdhënës ose 23.07 % kurse për nivelin *indiferent*, janë deklaruar 2 mësimdhënës ose 7.69 %.

*Histogrami 3.*


Çfarë ju shqetëson më shumë në klasë ?



Sipas deklarimeve të 157 mësimdhënësve të shkollave urbane, për nivelin *mungesa e mjeteve dhe teksteve mësimore* janë deklaruar 28 mësimdhënës ose 17.83 %, për nivelin *strategjitë e reja të mësimdhënies* janë deklaruar 69 mësimdhënës ose 43.94 %, për nivelin *realizimi i planprogramit* janë deklaruar 42 mësimdhënës ose 26.75 % dhe për nivelin *motivimi i nxënësve* janë deklaruar 18 mësimdhënës ose 11.46 %. Mësimdhënësit e shkollave rurale nga 26 sa ishin gjithsej për nivelin *mungesa e mjeteve dhe teksteve mësimore* janë deklaruar 8 mësimdhënës ose 30.76 %, për nivelin *strategjitë e reja të mësimdhënies* janë deklaruar 12 mësimdhënës ose 46.15 %, për nivelin *realizimi i planprogramit* janë deklaruar 4 mësimdhënës ose 15.38 dhe për nivelin *motivimi i nxënësve* janë deklaruar 2 mësimdhënës ose 7.69 %.

*Histogrami 4.*

Sa ju ndihmojnë trajnimet për zbatimin e strategjive të reja të mësimdhënies ?




Mësimdhënësit e shkollave urbane duket se janë përfshirë më tepër në trajnime dhe kanë deklaruar se atyre u ndihmojnë shumë dhe se nga trajnimet avancohen dhe sjellin risi në klasat e tyre dhe se ora mësimore bëhet më atraktive me përdorimn e strategjive bashkëkohore të mësimdhënies. Mësimdhënësit e shkollave urbane nga 157 të anketuar, në nivelin *shumë* janë deklaruar 134 mësimdhënës ose 85.35 %, në nivelin *pak* 20 mësimdhënës ose 12.73 % dhe nivelin *aspak* janë deklaruar 3 mësimdhënës ose 1.91 %. Sipas deklarimeve të mësimdhënësve të zonave

rurale nga 26 të anketuar për nivelin *shumë* janë deklaruar 19 mësimdhënës ose 73.07 %, në nivelin *pak* janë deklaruar 5 mësimdhënës ose 19.23 % dhe në nivelin *aspak* janë deklaruar 2 mësimdhënës të zonës rurale ose 7.69 %.

*Histogrami 5.*


**Sa ju shkakton stres kufizimi i kohës për t'i realizuar teknikat e mësimdhënies brenda një ore mësimore ?**



Mësimdhënësit e shkollave urbane nga 157 sa ishin gjithsej për nivelin *shumë* u deklaruan 24 mësimdhënës ose 15.28 % kurse ata të zonës rurale nga 26 sa ishin gjithsej u deklaruan 8 ose 30.76 %, për nivelin *pak* janë deklaruar 82 mësimdhënës të zonës urbane ose 52.22 % dhe 16 mësimdhënës të zonës rurale ose 61.53 %, për nivelin *aspak* u deklaruan 51 mësimdhënës ose 32.48 % të zonës urbane dhe 2 mësimdhënës ose 7.69 % të zonës rurale.


*Histogrami 6.*

**Sa janë të përshtatshme tekstet shkollore për zbatimin e strategjive të mësimdhënies ?**



Sipas anketimit me mësimdhënës në shkollat urbane dhe rurale sa i përket kësaj pyetjeje nuk ekziston ndonjë dallim i madh, shumë prej tyre shprehen se tekstet shkollore janë pjesërisht të përshtatshme. Mësimdhënësit e shkollave urbane, nga 157 sa ishin gjithsej për nivelin *shumë* u deklaruan 7 mësimdhënës ose 4.45 %, për nivelin *pjesërisht* 132 mësimdhënës ose 84.07 % kurse për nivelin *aspak* 18 mësimdhënës ose 11.46 %. Sipas deklarimeve të mësimdhënësve të shkollave rurale nga 26 sa ishin gjithsej për nivelin *shumë* janë deklaruar 2 mësimdhënës ose 7.69 %, për nivelin *pjesërisht* 19 mësimdhënës ose 73.07 % ndërsa për nivelin *aspak* 5 mësimdhënës ose 19.23%.

*Histogrami 7.*



Sipas anketimit me mësime në shkollat urbane dhe rurale sa i përket kësaj pyetjeje ekziston dallim i madh, shumë prej tyre shprehin se më të përshtatshme janë strategjitë bashkëkohore. Mësime të shkollave urbane, nga 157 sa ishin gjithsej 19 prej tyre u deklaruan për *tradicionale* ose 12.10 % dhe 138 arsimtarë u deklaruan për *bashkëkohore* ose 87.89 %. Sipas deklarimeve të mësimeve të shkollave rurale nga 26 sa ishin gjithsej për nivelin *tradicionale* janë deklaruar 5 mësime ose 19.23 %, për nivelin *bashkëkohore* u deklaruan 21 mësime ose 80.76 %.

#### 4. PËRFUNDIMI

Në bazë të rezultateve përfundimtare që dalin nga hulumtimi, dhe duke u mbështetur edhe në literaturën nga fusha e pedagogjisë, didaktikës si dhe nga lëmi i psikologjisë së edukimit, mund të nxirren këto përfundime të përgjithshme:

1. Mësime nuk kanë njohuri të mjaftueshme me metodologjitë e reja të mësimit, sidomos ata që punojnë në shkollat rurale.
2. Hartimi i teksteve në të shumtën e rasteve nuk është i përshtatshëm për mësime ndërvepruese dhe shumë pak i kushtohet rëndësi objektivave të niveleve të Taksonomisë së Blumit.
3. Shumë mësime nuk i zbatojnë metodologjitë e reja edhe pse kanë ndjekur trajnime. Disa prej tyre arsyetohen se nuk kanë kushte në shkollat e tyre, por unë mendoj se shumica e teknikave mund të aplikohen edhe në këto rrethana duke bërë përshtatje situatave të ndryshme.
4. Të krijohen mekanizma monitorimi dhe vlerësimi nga ana e DKA-së në Prizren për mësime të certifikuar që të përcjellin punën e tyre, kurse për mësime të patrajnuar të organizohen programe trajnime.
5. Udhëheqësit e shkollave nuk tregojnë interesim të mjaftueshëm për punën e mësimeve dhe në të shumtën e rasteve nuk ju ofrojnë materiale didaktike të mjaftueshme për mbarrëvajtje të procesit mësues. Vlen të theksohet se në disa shkollat nuk janë në gjendje të sigurojnë shumësia me ngjyrë dhe letër e formatit A4 e lere më për materiale të tjera didaktike më të kushtueshme.

Do të përfundoj me thëniet e dy autorëve mjaftë eminent mbi mësime:

*Ajnshtajni* shkruante: Mësime është arti më i lartë i mësuesit të zgjojë gëzim në të shprehurit dhe njohuritë krijuese”.

*Ralf Valdo Emerson* shpreh: “Ai që i bën të lehta gjërat e vështira është vetëm mësuesi”.

Shpresoj se nga të dhënat e këtij hulumtimi do të përfitojnë nxënësit dhe mësime, të cilët përmes zbatimit të mendimit kritik nëpër shkollat e tyre do të ndihmojnë në ngritje të cilësisë së arsimit dhe të përmirësimit të nxënësve në veçanti.

#### LITERATURA

- Buehl, D. (2001). *Classroom strategies for interactive learning (Strategji të të nxënësve ndërveprues në klasë; Botimi i dytë)*. Newark, DE: International Reading Association.
- Fullan, M. (2001). *Kuptimi i ri i ndryshimit në arsim*. Edualpa, Tiranë.

- Gashi-Shatri, Z. (2015, Maj). Bashkëkohorja kundrejt historikut në arsimin shqiptar. *Educatio 5 (Revista Ndërkombëtare e Shkencave të Edukimit dhe e Psikologjisë)*. VOL.5/Nr.1, ISSN: 2305-6614, f.56.
- Haxhijaha, E. (2015, July). *Të lexuarit e kuptimshëm dhe kritik te nxënësit e klasave të gjashta*. Second International Conference on Business, Law, Administration and Social Sciences (© IIPCCL). ISBN: 978-9928-178-40-4 (print); ISSN 2410-8693, p. 375. ILAR, Tiranë.
- Ismajli, H. (2012). *Teknologjia mësimore dhe të menduarit kritik*. Libri shkollor, Prishtinë.
- Këndusi, V. (2018). *Aftësimi profesional i mësimdhënësve për zbatimin e metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies*, Tiranë.
- MASHT (2015). *Katalogu i Trajnimeve të Akredituara 2015*. Raport nga Divizioni për Zhvillim Profesional të Mësimdhënësve, Prishtinë
- Musai, B. (1999). *Psikologjia e edukimit*. Pegi, Tiranë.
- Musai, B. (2003). *Metodologjia e mësimdhënies*. Pegi, Tiranë.
- Musai, B. & Ballhysa, A. & Gjokutaj, M. & Kërçiku, L. & Zisi, A. (2004). *Leximi shkrimi dhe diskutimi në çdo lëndë*. Udhëzues 3. KEC (Qendra për Arsim e Kosovës). Druck Art, Prishtinë.
- Musai, B. & Ballhysa, A. & Gjokutaj, M. & Kërçiku, L. & Zisi, A. (2004). *Zhvillimi kognitiv dhe social i fëmijës*. Udhëzues 2. KEC (Qendra për Arsim e Kosovës). Druck Art, Prishtinë.
- Musai, B. (2005). *Mësimdhënia dhe të nxënët ndërveprues (Për klasat 6 – 12)*. Qendra për Arsim Demokratik (CDE), Tiranë.
- Rruka, V. (2016). *Motivimi i nxënësve për të lexuar, në kontekst të vetë konceptit si lexues dhe vlerave që i kanë për leximin*. Prizren, Kosovë.
- Temple, CH. & Crawford, A. & Saul, W. & Mathews, S. & Makinster, J. (2006), *Strategji të mësimdhënies dhe të të nxënët për klasat mendimtare*, Botim i projektit “Zhvillimi i të menduarit kritik gjatë të lexuarit dhe të shkruarit”. CDE. Tiranë.
- Zwiers, J. (2005). *Zhvillimi i shprehive të të menduarit në klasat 6 – 12*. Qendra për Arsim Demokratik CDE, Tiranë.